




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTERRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja urgjente e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
22 shtator 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Fatmire Cecelia, Refik Maloku, Afrim Namani, Bajrush Kosumi), si dhe nga sekretaria e kuvendit: Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ai tha se jemi dakorduar në mbledhjen e fundit të KPF-së që nëse vjen Qarkorja e tretë buxhetore para mbledhjes së kuvendit të komunës ta mbajmë edhe një mbledhje të KPF-së në mënyrë që të analizohet më mirë.

Po ashtu, në të njëjtën kohë janë paraqitur edhe disa pika tjera, që e pashë të arsyeshme t'i sjelli këtu në KPF për diskutim sesa t'i dërgojmë direkt në kuvend.

Lidhur me pikën 2. "Shqyrtimi i propozim – vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të teatrit të qytetit Vushtrrisë me nr. 228/14 i datës 30.10.2014", sot ka ardhur një peticion nga komuniteti artistik për mosndryshimin e emrit të teatrit dhe sekretaria ua ka shpërnda si material. Ai kërkoi që asnjë material mos të procedohet pa shkresë përcjellëse nga propozuesi i dokumentit.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – në literaturë nuk njoh mbledhje urgjente të KPF-së. Përveç pikës për buxhetin, nuk po i shoh që pikat tjera janë të natyrës urgjente. Ai tha se nuk është mirë të vihen në pozitë të palakmueshme anëtarët e kuvendit lidhur me propozimin për ndryshimin e emrit të teatrit të qytetit. E kam parë në rrjetet sociale që shumë njerëz po e kundërshtojnë ndryshimin e emrit e po ashtu edhe një peticion nga komuniteti artistik që po e kundërshton një gjë të tillë.

Në komunën tonë kemi pasur edhe aktorë tjerë që kanë vdekur dhe nuk kemi menduar që ta ndryshojmë emërtimin, pasi që vet emërtimi <teatri i qytetit> i nderon të gjithë.

Propozimi im është që përveç pikës 1 "Shqyrtimi i draft - buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2021", mos të shqyrtohen pikat tjera.

Melihate Basholli - Latifi, anëtare e KPF-së – edhe unë propozoj që përveç pikës 1 "Shqyrtimi i draft - buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2021", mos të shqyrtohen pikat tjera, sepse nuk janë të natyrës urgjente.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se në mbledhjen e fundit të KPF-së ishte në rend të ditës “Shqyrtimi i draft - buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2021” dhe këtë pikë nuk e kemi trajtuar për shkak se ka munguar materiali. Mirëpo, nuk po shoh asgjë të keqe nëse i trajtojmë edhe pikat tjera, përveç buxhetit, sepse më mirë të kalojmë nëpër filtra si në KPF se sa të na vijnë direkt në kuvend.

Ai tha se artistët e popullit që vijnë nga Vushtrria duhet të nderohen në forma të ndryshme, e njëra nga format është që t’i vihet një emër ndonjë institucioni.

Melihate Basholli - Latifi, anëtare e KPF-së – theksoi se sikur të ishte në rend të ditës në një mbledhje të rregullt të KPF-së “Shqyrtimi i propozim – vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të teatrit të qytetit Vushtrrisë me nr. 228/14 i datës 30.10.2014”, nuk do të kishte nevojë për këtë diskutim fare, por kjo mbledhje është urgjente dhe të respektohet legjislacioni në fuqi.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se në këto rrethana nuk i bën as komitetit një diskutim i tillë. U sqarua edhe nga kryesuesi dhe nga Ymeri se kjo mbledhje është thirr urgjente për ta trajtuar buxhetin, por në ndërkohë janë paraqitur edhe pikat tjera dhe kryesuesi i kuvendit e ka parë të arsyeshme t’i sjell në KPF për trajtim.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se a ekziston ndonjë formë të shtyhet buxheti, pasi që është koha e shkurtër për trajtimin e tij.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se afati për miratimin e buxhetit është 30 shtatori sipas ligjit. Është bërë kërkesë nga komunat që të shtyhet ky afat, por nuk është shtyrë nga ministria.

Pas debatit, kryesuesi i kuvendit dhe KPF-së e hodhi në votim rendin e ditës, ku të pranishëm ishin tetë (8) anëtarë dhe katër (4) votuan “për”, kurse katër (4) nuk morën pjesë në votim. Pasi që nuk kishte kuorum për marrjen e vendimeve, kryesuesi i kuvendit kërkoi pauzë pesë minuta.

Komiteti për Politikë dhe Financa me katër (4) vota “për” dhe një (1) votë “kundër” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i draft - buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2021;
2. Shqyrtimi i propozim – vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të teatrit të qytetit Vushtrrisë me nr. 228/14 i datës 30.10.2014;
3. Shqyrtimi i Planit të veprimit mbi rekomandimet e auditorit të përgjithshëm;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimeve për anëtarësim në komitete konsultative;
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin të komisionit për ankesa;
6. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i draft - buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2021.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se buxheti për vitin 2021 është për 1,621,38.00€ më i vogël krahasuar me vitin paraprak, kurse në investime kapitale kemi

667,237.00€ më pak, kurse subvencionet i kemi për 307,000.00€ më shumë, që d.m.th kemi 600 mijë euro subvencione.

Ai tha se qarkorja na ka ardhur shumë vonë dhe ka mundësi që na ka rrjedh edhe ndonjë gabim teknik në tabela. Prandaj, deri në mbledhjen e kuvendit ka mundësi që të bëhet edhe ndonjë përmirësim brenda drejtorive, por kategoritë ekonomike dhe grantet specifike nuk do të preken.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se tek ndërtimet e kanalizimeve, duke e parë që ka shumë kërkesa nga qytetarët (jo që nuk është e rëndësishme asfaltimi i rrugëve), konsideroj që ndoshta do të ishte mirë të rritet vlera të ndërtimi i kanalizimeve nga ndonjë kod. Pra, të gjendet ndonjë mundësi, tha ai.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – theksoi se parashihet që në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike t'i ipet komunës edhe një buxhet shtesë muajve në vazhdim. Edhe këtë buxhet do ta trajtojmë njëjtë sikur buxhetin e komunës.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se në tabelën 4.1, nga hyrat vetanake kemi totalin prej 2, 097,054.77€, kurse tek tabela e të hyrave vetanake 2021 - 2023, <totali i administratës komunale> kemi 1,780,903.00€, d.m.th .kemi një mospërputhje.

Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar – tha se pajtohet se ekziston ajo mospërputhshmëri, por kjo do të bëhet në kuadër të ndryshimeve që i përmendi drejtori dhe në fund do të kemi një përputhshmëri.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota "për" rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

2. Shqyrtimi i propozim – vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të teatrit të qytetit Vushtrisë me nr. 228/14 i datës 30.10.2014.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me katër (4) vota "për", një (1) votë "kundër" rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Planit të veprimit mbi rekomandimet e auditorit të përgjithshëm.

Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar – tha se kryetari i komunës e pati krijuar një grup koordinues për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm,. Ky grup e ka hartuar edhe planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve.

Prandaj, jemi të obliguar që dy herë në vit ta dërgojmë në kuvend për shqyrtim Planin e veprimit mbi rekomandimet e auditorit të përgjithshëm, tha ai. Qëllimi i kësaj është që edhe kuvendi i komunës ta jep kontributin e tij lidhur me këtë plan të veprimit.

Ai tha se afati për shqyrtimin e këtij plani në kuvendin e komunës është deri më 30 shtator.

Abiti deklaroi se nuk qëndrojmë aq mirë me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – meqenëse e kam udhëhequr këtë proces, po ju informoj se si qeverisje komunale e kemi përkushtimin maksimal që këto rekomandime të zbatohen të gjitha. Se a është e mundur që të zbatohen të gjitha, nuk e di, sepse është sfiduese, sepse me këtë buxhet të kufizuar e kemi shumë vështirë. Po ashtu jemi duke bërë përpjekje që në

buxhetin e vitit 2021 mos të bëjmë keqklasifikime në asnjërën prej kategorive buxhetore. Prandaj, në bashkëpunim me kuvendin besoj që do të arrijmë ta hartojmë një buxhet, i cili është në interes të qytetarëve dhe parane publike ta shndërrojmë në sa më shumë vlerë për qytetarët.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota "për", rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimeve për anëtarësim në komitete konsultative.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – deklaroi se e përgëzon komisionin për punën që kanë bërë në përzgjedhjen e anëtarëve në komitete dhe sa e pashë shumica janë të rinj dhe shpresojmë se do të kanë vullnet për t'u angazhuar.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota "për", rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin e komisionit për ankesa.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota "për", rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – u shpreh se është marrë vendim në kuvend që të gjithë anëtarët e kuvendit të pajisen me laptop, ku është ndarë edhe buxheti. Ai pyeti se a ka gjasa që ky vendim i kuvendit të implementohet?

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – tha se do të bisedon me kryetarin e komunës së a ekziston ndonjë mundësi ligjore buxhetore për t'i pajisur me laptop anëtarët e kuvendit.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – theksoi se të gjitha mjetet që kanë qenë të planifikuara për teknologji informative janë marrë nga përmburuesi për çështjen e mësimdhënësve.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës

